



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 11 VENDIMI

Tiranë, më 10.4.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesues
Roland Ilia	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Ina Serjanaj;
pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, në datën
10.04.2018, ora 15:00, në sallën nr.1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori
në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z. Ermir Beta - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat

BAZA LIGJORE : Neni 179/b, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni G i Aneksit
Kushtetues, neni 14 e 57 i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të
gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Arsyet për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit:

Subjekti i rivlerësimit, Z. Ermir Beta ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë
pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.



Subjekti i rivlerësimit, Z. Ermir Beta ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesën nr. 541, në datën 5.3.2018.

Neni G i Aneksit Kushtetues ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

“Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare”.

Neni 64, germa a), e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se një nga mënyrat e mbarimit të statusit të magjistratit është dorëheqja.

Neni 160, pika 2, germa dh) i këtij ligji parashikon se deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm vërteton mbarimin e emërimit në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit.

Nëpërmjet shkresës nr.1117 prot., datë 6.4.2018, Prokuroria e Përgjithshme i ka njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vendimin nr. 85, datë 15.3.2018, me të cilin ka pranuar dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, Z. Ermir Beta dhe ka vendosur mbarimin e emërimit të prokurorit sipas dekretit nr.5925, datë 6.11.2008 të Presidentit të Republikës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit Kushtetues dhe neneve 14 e 57, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për Z. Ermir Beta, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, është ndërprerë.

Ky vendim u njoftohet Z. Ermir Beta, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.



ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

XHENSILA PINE

Kryesues

ROLAND ILIA

Relator



GENTA Tafa (BUNGO)

Anëtar

Ky vendim shpallet në datën 10.04.2018.